



Prishtinë, 29.07.2022  
Kodi i ZRRE-së: V\_1564\_2022

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2314\_06\_22** i dt. **08.06.2022**;
- Ankesë e konsumatorit e datës **15.07.2022**,

në seancën e mbajtur më datë **29.07.2022** nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Sh. A., nga komuna e Prishtinës si e pa bazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2314\_06\_22, i datës 08.06.2022.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 08.06.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2314\_06\_22 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht ankesën e konsumatorit Sh. A., dhe e ka obliguar KESCO-n që të bëjë korigjimin e faturës nr. 1221280758DPR- 90163083 datë 22.12.2021 në vlerë financiare **-53.19€** si dhe konsumatorit ti ofron kontratë pagese prej 12 muajve.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori Sh. A., brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Konstaton se vendimi i kontestuar nuk është i drejtë dhe i plotë;
- Kërkon rishqyrtim më të detajuar dhe meritore;
- bashkëngjijt një kopje të faturës së fundit si provë teknike për të dëshmuar se konsumi mesatar mujor është shumë më i ulët se ajo që është cekur në vendim.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.07.2022 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se vendimi nuk është i drejtë dhe i plotë, ZRrE thekson se pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, e në veçanti Procesverbalit për pranimin e instalimit elektrik nr. 0066978 datë 04.11.2021; Procesverbalit mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorisë elektrik nr.



0001736 datë 04.11.2021; Faturat nr. 101-DPR21S456157 datë 06.12.2021 dhe nr. 1221280758DPR-90163083 datë 22.12.2021; Ankesa e konsumatorit ne KESCO datë 22.12.2021 ; Përgjigja e KESCO-s datë 02.03.2022; Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 10.03.2022; Vendimi i DMK-së ZRrE/DMK\_V\_2314\_06\_22, i datës 08.06.2022; Ankesa e konsumatorit e datës 15.07.2022; Fatura e konsumatorit; Transaksionet e konsumatorit; Rrjedha e energjisë elektrike, dhe ka gjetur se ky pretendim nuk qëndron si i tillë, sepse, nga të gjitha provat e përmendura si më lartë, pa mëdyshje vërtetohet fakti se kWh e faturuar paraqesin shpenzimet e regjistruara dhe grumbulluar në njehsorin elektrik nr. 40672427 e që kjo vërtetohet edhe me dy procesverbalet, në procesverbalin për pranimin e instalimit elektrik nr. 0066978 datë 04.11.2021 dhe procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr. 0001736 datë 04.11.2021. Po ashtu nga dy procesverbalet e përpiluara nga ekipet e KEDS-it vërehet se njehsori elektrik ka pasur të regjistruar shpenzimet në tri tarifa. Sipas faturës kontestuese vërehet se kWh e regjistruar ne tarifën e parë dhe të tretë janë bashkuar dhe janë faturuar si shpenzim i lartë duke mos e ditur saktë kohen për të cilën shpenzimet e tarifës së tretë janë regjistruar në tarifën e tretë.

Bordi ka analizuar edhe rrjedhën e energjisë elektrike dhe ka vërejtur se DMK duke pasur parasysh edhe rrjedhën e energjisë elektrike si dhe mesataren mujore të shpenzimit të konsumatorit me njehsorin e ri elektrik nr. 20070767 prej 849 kWh/muaj ka bërë shpërndarjen e kWh të faturuara në faturën nr. 1221280758DPR- 90163083 datë 22.12.2021 për periudhën 19 mujore si dhe ka bërë ndarjen e kWh të regjistruar në tarifën e tretë bazuar në % e totalit të shpenzimeve në tarifën e lartë dhe të ulet (I dhe II) me njehsorin nr. 40672427 dhe konstaton se konsumatorit duhet 'ti bëhet korrigjimi në vlerë financiare **-53.19€** si dhe t'i ofrohet kontratë pagese prej 12 muajve.

Bazuar ne te gjitha analizat e bëra konstatohet se KESCO në rastin e faturimit të kWh të regjistruar në njehsorin elektrik nr. 40672427 nuk ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifën tjetra, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.*

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.07.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Ymer Fejzullahu, Kryesues

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

---

Lutfije Dervishi, anëtare

---

Gani Buçaj, anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- KESCO-s,
- Konsumatorit Sh. A., dhe
- Arkivit të ZRRE-së.